



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 17.9.2008, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje **morën pjesë**: Lulzim Zeneli, Berat Luzha, Kosara Nikolić, Elheme Hetemi, Zulfi Merxha, Zef Morina, Ibrahim Selmanaj, Selvie Halimi, Ali Lajçi, dhe Myrvete Pantina. **Mungoi** : Hestet Cakolli

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Nga MBPZHR : Isah Rudaku dhe Idriz Gashi , nga OSCE Maria Berishaj dhe Nexhat Shatri nga Presidenca

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Drita Çarkaxhiu, Lule Ymeri

Mbledhjen e kryesoi : **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për Inspektionin Bujqësor,**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës, e cila pësoi ndryshim në bazë të propozimit të **Berat Luzhës** për të shqyrtuar ligjin e panënskruar nga PSSP nr.03/L-004 për plotësim e ndryshim të Ligjit nr. 2003/9 për Kooperativat e Bujqve dhe për shqyrtimin e planit 6 mujor të punës së komisionit.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

2. Shqyrtimi Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës e cila ende nuk është shpallur nga PSSP nr. 03/L-004 për plotësim e ndryshim të Ligjit nr. 2003/9 për Kooperativat e Bujqve

Kryetari sqaroi se disa ligje të pashpallura nga PSSP janë kthyer për rishqyrtim komisioneve parlamentare sipas propozimit të GP-ve , një ndër të cilët është edhe ky ligj. Adm. i komisionit sqaroi shkurtimisht procedurën pasi që të parën herë kthehet një ligj në komision për rishqyrtim. Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Të procedohet ky ligj në për miratim të Kuvendit me dy Amendamente :

1. Pasusi i parë i preambulës riformulohet :

“Në bazë të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,” dhe

2. Neni 8 të riformulohet : “Ky ligj hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjet) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.”

3. Shqyrtimi i projektligjit për Inspektionin Bujqësor

Në fillim zyrtarët e MBPZHR , sipas kërkesës së Kryetarit, sqaruan shkurtimisht synimet e këtij projektligji dhe kërkuan nga komisioni që gjatë shqyrtimit detal të kontribuoi në eliminimin e gabimeve eventuale, kërkuan që preambula dhe neni i fundit të rregullohen sipas kushtetutës në fuqi, çka **u miratua** nga komisioni.

Berat Luzha kërkoi nga zyrtarët e ministrisë të përmirësojnë titullin e ligjit, ngase është e përgjithësuar, kemi disa fusha prandaj, ndërkaq **Ali Lajçi** tha se fjala inspektion duhet të zëvendësohet me inspektim. **Kosara Nikoliq** tha se fushat e cekura tek neni 3 duhet ti shtohen edhe nenit 1, mirëpo në debatin e mëtejme neni 1 mbet ashtu si është.

Amendamenti 1

Neni 2, në pikën 6 në reshtin e dytë pas fjalës “inspektionin” shtohet “e nivelit”.

Neni 3 - duhet të sqarohet nga zyrtarët e MBPZHR se a duhet të shtohet fushveprimtaria inspektive për tokën bujqësore dhe për secilin fushë të epen sqarime për çfarë kompetencash bëhet fjalë si dhe sipas propozimit të **Selvie Halimit Neni 4** - për kompetencat e nivelit lokal të propozohet si duhet të rregullohet.

Amendamenti 2

Neni 5, paragrafi 1, pas fjalës “inspektorët” shtohet “e nivelit qendror”.

Amendamenti 3

Neni 7, paragrafi 1, në fillim “është i autorizuar të”, fshihet.

Amendamenti 4

Neni 8, paragrafi 1 pika 1, fshihet, ndërsa fjala e fundit e këtij neni “trakes” zëvendësohet me “shiritit”.

Amendamenti 5

Neni 11, fjalia “dispozita ligjore” zëvendësohet me “akte nënligjore”, ndërsa te **Neni 13**, paragrafi 2, në reshtin e 2, pas “me” shtohet “këtë”.

Amendamenti 6

Neni 15, paragrafi 1, në reshtin e parë pas “kryerjen” shtohet lidhësja “e”, paragrafi 2 riformulohet : **“Punët e caktuara tekniko-profesionale si ekspertizë, hulumtime laboratorike, mund të kryhen në institucionet e specializuara”.**

Amendamenti 7

Neni 16, paragrafi 1, fjalia “Shërbimit Policor të Kosovës” zëvendësohet me “Policisë së Kosovës”.

Neni 19 të diskutohet sërish në mbledhjen e radhës për fjalën “legjitimacion” a duhet të mbetet ashtu apo “legjitimitet”, gjithashtu edhe **Neni 23** mbetet të sqarohet për atë mbledhje me propozim që fjala “mostrimit” të zëvendësohet me “marrjes së mostrave” dhe “me ligj” të zëvendësohet me “akte nënligjore”. Për **Nenin 27** komisioni kërkoi analizë nga MBPZHR ose të fshihet.

Amendamenti 8

Neni 30, afati “një viti” zëvendësohet me “9 (nëntë) muaj”.

Për **Nenin 31** kryetari tha se MEF pretendon të jetë ministria kryesore, por megjithatë komisioni nuk ndryshoi asgjë.

Amendamenti 9

Neni 32, riformulohet sipas standardit të kushtetutës në fuqi “**Ky ligj hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjet) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.**” duke e fshi paragrafin 1.

4. Plani i punës 6 mujore të Komisionit (deri në fund të vitit)

Kryetari theksoi se ky draft plan i dorëzuar anëtarëve të komisionit është propozuar si plan unik për të gjitha komisionet parlamentare, mirëpo ai mund të plotësohet vazhdimisht sa i përket ligjeve dhe programit të komisionit në veçanti.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

MIRATOHET NË PARIM plani 6 mujor i komisionit me mundësi të plotësimit sa i përket aktiviteteve të komisionit me ligje.

Maria Berishaj nga OSCE njoftoi komisionin për agjendën e vizitës së komisionit në Kroaci me dt.22.9.2008.

Mbledhja përfundoi në orën 14,10

Kryesuesi i Komisionit,
Lulzim Zeneli